

## 7

## EMËRTIMI I KISHËS SË JEZUSIT

Kur të pagëzoheni, Zoti do t'ju shtojë në kishën e tij. Pastaj do duhet të veproni si anëtarë të kishës së Zotit. Meqënëse ka shumë kisha në ditët e sotme,<sup>1</sup> nuk është e lehtë të identifikosh kishën e Jezusit. Në mësimet e ardhshme do të shqyrtojmë karakteristikat e kishës në Dhjatën e Re. Çdo organizatë fetare duhet të vlerësohet në dritën e këtyre karakteristikave.

Koha dhe vendi nuk lejojnë studimin në thellësi të secilit tipar. Në qoftë se do t'ju lindin pyetje, i shkruani ato dhe ia tregoni atij që ju dha këtë botim. Ai do të jetë i gatshëm të studiojë më në thellësi me ju për secilën nga këto çështje.

Në fillim do të trajtojmë emërtimin biblik. Do të shikojmë se si Bibla i referohet kishës si e tërë, pastaj se si emërtohen anëtarët e kishës.

**EMËRTIMI: PREJARDHJA**

Para se të trajtojmë emërtimet specifike, do të doja të thosha disa fjalë për prejardhjen. Së pari, vini re se përdor fjalën “emërtimet” dhe jo “emrat”. E bëj këtë, sepse në Dhjatën e Re kisha nuk ka emër të vetëm.<sup>2</sup>

Cili është ndryshimi midis “emërtimit” dhe “emrit”? Ndoshta jeni të ulur diku ndërsa po lexoni tani. Për qëllime ilustrimi, le të supozojmë se jeni ulur në karrige. Në qoftë se e quani atë “karrige” (apo “ndenjëse” apo diçka të ngjashme), ju thjesht po thoni se çfarë është. Kjo është një fjalë përshkruese. Është emërtim. Megjithatë, mund të vendosni t'i vini një emër. Për shembull, mund ta quani atë “Elsa” (me “E” të madhe), “karrigia Elsa”. Ky do të ishte një emër i përveçëm.

Vërtet, ilustrimi im është qesharak, por po përpiqem t'ju bëj të kuptoni se Dhjata e Re përdor

vetëm emërtime për kishën, jo emra të përveçëm. Të gjitha fjalët e përdorura për të emërtuar kishën thjesht tregojnë se çfarë është ajo.

Meqënëse kjo është e vërtetë, sa herë që përdor një emërtim për kishën e Zotit, fjalën “kishë” e shkruaj me “k” të vogël.<sup>3</sup> Nuk po trajtoj këtu çështjen e emërtimeve, por dua të theksoj, se po përdor një emërtim dhe jo një emër të përveçëm.

Së dyti, si rregull, emërtimet e kishës i japin titullin e nderit Krishtit dhe Atit të tij. Jezusi ka “një emër që është përmbi çdo emër” (Filipianëve 2:9). Emrat e sekteve të ndryshme fetare shpesh lartësojnë disa karakteristika të sektit, një themelues apo doktrinë. Vetëm Zoti duhet të lartësohet. Pjetri tha se “në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër në qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem” (Veprat 4:12).

**EMËRTIMI I KISHËS SI E TËRË**

Duke i mbajtur këto në mendje, le të shikojmë së pari emërtimet për kishën si e tërë. Shumicën e herëve në Dhjatën e Re, kisha thjesht quhet “kishë” (Veprat 5:11; 8:1, 3; 9:31; 11:22, 26). Prandaj, kur shkruaj apo mësoj, zakonisht i referohem kishës si asgjë tjetër përveçse “kishë”.

Disa herë, Bibla përdor fraza përshkruese për t'iu referuar kishës. Për shembull, Pali iu referua kishës si “Kisha e Zotit” (Veprat 20:28). Hebrenjve 12:23 e quan kishën “kisha e të parëlindurve”.<sup>4</sup> Një fjalë e përdorur shpesh është “kisha e Perëndisë” (1 Korintasve 1:2; 15:9; 2 Korintasve 1:1; Galatasve 1:13; 1 Timoteut 3:15).

Te Romakëve 16:16 Pali iu referua disa bashkësive në vendin e tij kur tha: “Kishat e

Krishtit ju përshëndesin”.<sup>5</sup> “Kishat e Krishtit” nuk është një emër sekti, përkundrazi është një frazë përshkruese. “E Krishtit” do të thotë “që i përkasin Krishtit”. “Kishat e Krishtit” do të thotë “kishat që i përkasin Krishtit”. Kur përdor fjalën “kishë e Krishtit” apo “kishat e Krishtit” e kam fjalën për kishën apo kishat (bashkësitë) që i përkasin Jezusit.

### **EMËRTIMI I ANËTARËVE INDIVIDUALË TË KISHËS**

Si emërtohen anëtarët individualë të kishës? Një larmi fjalësh janë përdorur në Dhjatën e Re për t’iu referuar anëtarëve individualë. Ja disa prej tyre:

- “Vëllezër dhe motra” (Veprat 6:3; 9:30; Romakëve 16:1; Jakobi 2:15). Kjo është fjala më e përhapur që përdoret. Ajo tregon marrëdhënie të një familjeje (familje shpirtërore).
- “Shenjtorë” (Romakëve 1:7; 8:27; 12:13; 15:25). “Shenjtor” nuk do të thotë “i pamëkat”, por “i veçuar”. Në momentin e pagëzimit Perëndia i veçon kristianët si popullin e tij të zgjedhur (Titit 2:14).
- “Dishepuj” (Veprat 6:1, 2, 7; 9:1). Kjo fjalë është përdorur në librin e Veprave për t’iu referuar ndjekësve të Krishtit. Fjala nënkupton një “ndjekës”, një “nxënës”.<sup>6</sup>

Emërtimi dallues për anëtarët individualë të kishës është fjala “kristianë”. Luka tha se “për të parën herë në Antioki, dishepujt u quajtën të Krishterë” (Veprat 11:26). Pasi Pali i predikoi mbret Agripës, mbreti i tha atij: “Për pak dhe po ma mbush mendjen të bëhem i krishterë” (Veprat 26:28). Pjetri shkroi: “Por, nëse dikush vuan si i krishterë, le të mos ketë turp, por le të përlehtëtojë Perëndinë për këtë” (1 Pjetër 4:16).

E thashë më parë se, si rregull, emërtimet e Dhjatës së Re nderojnë Jezusin dhe Perëndinë. Kjo është e dukshme në fjalën “i krishterë” ku dy të tretat e fjalës është “krisht”.

Fjala “i krishterë” është huazuar nga fjala greke. Fjala origjinale greke kombinon fjalën “krisht” me një mbaresë që tregon pronësi. “I krishterë” fjalë për fjalë do të thotë “ai që i

përket Krishtit”.

### **I KRISHTERË = AI QË I PËRKET KRISHTIT**

Kjo fjalë ka në planin individual ka po atë kuptim që ka “kisha e Krishtit” në planin kolektiv. “I krishterë” do të thotë individ që i përket Krishtit, kurse “kisha e Krishtit” do të thotë kisha që i përket Krishtit.

Kur më pyesin se çfarë jam nga pikpamja fetare, u përgjigjem: “Jam i krishterë”. Nganjëherë vazhdojnë të më pyesin: “Por anëtar i cilës organizate fetare je?” Pastaj u përgjigjem: “Jam anëtar i kishës që i përket Krishtit” apo “i kishës së Krishtit”. Gjithmonë dua të nderoj Zotin tim, Jezusin.

### **KONKLUZION**

Mbajtja e emrave të krijuar nga njerëzit kontribuon në përçarjen e kristianëve sot. Kjo është e vërtetë sot siç ishte edhe në kohën kur u shkrua Bibla. Kur Pali i shkroi kishës në Korinth, përçarja po e gërryente atë kishë:

Tani vëllezër, ju bëj thirrje në emër të Zotit tonë Jezu Krishtit të flisni që të gjithë të njëjtën gjë dhe të mos keni ndasi midis jush, por të jeni plotësisht të bashkuar, duke pasur një mendje dhe një vullnet. Sepse më është treguar për ju, o vëllezër, nga ata të shtëpisë së Kloes, se në mes jush ka grindje. Dhe dua të them këtë, që secili nga ju thotë: “Unë jam i Palit”, “unë i Apolit”,<sup>7</sup> “unë i Kefës”<sup>8</sup> dhe “unë i Krishtit” (1 Korintasve 1:10–12).

Fraza si “i Palit” dhe “i Apolit” tregojnë pronësi, siç u përmend më sipër, sipas Romakëve 16:16. Ato fjalë për fjalë do të thonë “i përkas Palit”, “i përkas Apolit”, etj. Sot mund të thoshim: “Jam Palian” apo “Apolosian”. Pali i turpëroi ata që e identifikonin veten në këtë mënyrë duke pyetur: “Vallë i ndarë qenka Krishti? Mos Pali u kryqëzua për ju? Apo ju u pagëzuat në emër të Palit?” (1 Korintasve 1:13). Vetëm Krishti u kryqëzua për mëkatet e njerëzve (1 Korintasve 1:23). Besimtarët pagëzohen në emër të Krishtit (Veprat 2:38), prandaj ata duhet të mbajnë vetëm emrin e tij.

Mos më keqkuptoni. Një emërtim korrekt nuk është i mjaftueshëm në vetvete. Mund të shkruaj

fjalën “Mercedes Benz”<sup>9</sup> në makinën time, por prapë ajo nuk do të jetë e tillë. Megjithatë, emërtimi biblik është i rëndësishëm. Mbani mend se Pjetri, lidhur me emrin e Krishtit, tha: “Nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohemi” (Veprat 4:12). Ai më vonë shkroi: “Le të përlëvdojë Perëndinë për këtë” (1 Pjetër 4:16). ❖

---

<sup>1</sup> Kur studioj biblën me njerëz të ndryshëm, ata shpesh më pyesin: “Meqenëse kishte vetëm një kishë në kohën e Biblës, nga erdhën gjithë këto kisha?” apo: “Pse ekzistojnë tërë këto sekte fetare?” Përgjigja më e thjeshtë është se njeriu u largua nga e vërteta, tamam ashtu siç ishte profetizuar. (Lexoni Veprat 20: 29, 30; 1 Timoteut 4:1–3; 2 Timoteut 4:1–4.)

<sup>2</sup> Si rregull emri i përveçëm shkruhet me shkronjë të madhe.

<sup>3</sup> Përjashtim bëhet kur fjala “kishë” vendoset në fillim të fjalisë.

<sup>4</sup> Në tekstin origjinal, fjala “të parëlindur” është në shumës. Fjala do të thotë “kisha e përbërë nga të parëlindurit”, pra, kristianët.

<sup>5</sup> Romakëve 16:16 fillon: “Përsëritet njëri tjetrin me një të puthur të shenjtë.” Në ato kohë, burrat e përsëriteshin njëri-tjetrin me një të puthur dhe gratë e përsëriteshin njëra-tjetrën po me një të puthur (siç është akoma në Shqipëri). Kjo nuk është komandë që përsëritet njëri tjetrin me një të puthur. Theksi është në fjalën “të shenjtë”. Kur përsëritet njëri tjetrin me ngrohtësi, bëjeni me gjithë mend. Në vendin prej nga jam unë, mund të thoshim: “Përsëritet njëri tjetrin me një dhënie dore të sinqertë.”

<sup>6</sup> “Dishepulli” mund të jetë ndjekës i çdo udhëheqësi. Situata e veçantë e përcakton nëse është fjala për një ndjekës të Krishtit apo jo.

<sup>7</sup> Apollo ishte një predikues që punoi për pak kohë në qytetin e Korintit (që ishte në krahinën e Akaisë). (Shiko Veprat 18:27, 28.)

<sup>8</sup> Kefa është një emër tjetër për apostullin Pjetër (Gjoni 1:42).

<sup>9</sup> Markë makinash shumë të shtrenjta.

Autor: *David Roper*  
Marrë nga studimi: *“Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve”*  
© 2001, 2003 E VERTETA PËR SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara